



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**VENDIM**

**Nr. 143/2019**

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E AFATIT TË GJENDJES  
SË FATKEQËSISË NATYRORE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 18, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, deri në datën 31.3.2020.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 18.12.2019